



# SA PO FUNKSIONON MËSIMI NË DISTANCË?

PERCEPTIMET E MËSUESVE DHE NXËNËSVE  
TË SHKOLLAVE PUBLIKE PROFESIONALE

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Raporti u përgatit nga Migena Kapllanaj dhe Bernard Zeneli, konsulentë të projektit, nën mbikqyrjen e Erka Çaro, Eksperte e Monitorimit e Matjes së Rezultateve.

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë”**

“Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të: krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave novatore të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

**Shënim:** Pikëpamjet e shprehura janë të autorit dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Swisscontact ose Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC).

## Përmbajtja

LISTA E SHKURTIMEVE .....	3
PASQYRA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE.....	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
2. HYRJE .....	6
3. ORGANIZIMI I PROCESIT MËSIMOR NË DISTANCË .....	7
3.1. PROCESET E RAPORTIMIT DHE VLERËSIMIT DIGJITAL NË AFP.....	7
3.2. PLATFORMAT NË PËRDORIM PËR MËSIMIN NË DISTANCË .....	8
4. METODOLOGJIA E SONDAZHEVE DHE E STUDIMIT .....	9
4.1. PJESËMARRJA NË SONDAZHE.....	9
4.2. INSTRUMENTET .....	10
4.3. KONSIDERATA ETIKE .....	11
4.4. KUFIZIMET E STUDIMIT .....	11
5. REZULTATET DHE ANALIZA E SONDAZHEVE .....	12
5.1. REZULTATET NGA SONDAZHI ME MËSUES .....	12
5.2. REZULTATET NGA SONDAZHI ME NXËNËS.....	15
5.3. KRAHASIME MES PERCEPTIMEVE TË MËSUESVE DHE NXËNËSVE.....	20
6. KONKLUZIONE .....	21
7. REKOMANDIME.....	21
8. ANEKSE.....	24
8.1. RAST STUDIMI: PLATFORMA DIGJITALE “MËSOVET” .....	24
8.2. REZULTATE NGA PËRDORUESIT E MËSOVET .....	26
8.3. ANALIZË E DETAJUAR STATISTIKORE PËR REALIZIMIN E PRAKTIKËS .....	34
8.4. TEKSTI I PYETËSORËVE TË PËRDORUR GJATË SONDAZHEVE .....	35
8.5. TABELA ME INFORMACION MË TË HOLLËSISHËM STATISTIKOR.....	40
8.6. INSTRUMENTET E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT NË SHKOLLA .....	44

## Lista e shkurtimeve

AFP - Arsimi dhe Formimi Profesional  
S4J - Projekti "Aftësi për Punë"  
AKPA - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive  
MASR - Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë  
MEF - Ministria e Ekonomisë dhe Financave  
ASCAP - Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar  
AKAFPK – Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

## Pasqyra e tabelave dhe grafikëve

Tabela 1: Pjesëmarrja e mësuesve sipas shkollave dhe në raport me popullatën e mësuesve .....	9
Tabela 2: Numri i nxënësve në sondazh sipas shkollave dhe në raport me popullatën e nxënësve ....	10
Tabela 3: Vlerësimet që janë në përdorim nga mësuesit sipas nxënësve .....	43
Figura 1: Elementet e raportimit për mësimin në distancë në përdorim në AFP .....	7
Figura 2: Vlerësimet e mësuesve për situatën e mësimin në distancë .....	12
Figura 3: Aplikacioni ose platforma në përdorim nga mësuesit .....	12
Figura 4: Arsyet e mësuesve për përdorimin e metodës së zgjedhur .....	13
Figura 5: Sfidat e mësuesve për mësimin në distancë online .....	13
Figura 6: Kontributi i mëtejshëm i projektit "S4J" sipas mësuesve .....	14
Figura 7: Vazhdimi me mësimin në distancë edhe më pas .....	14
Figura 8: Nxënësit në sondazh sipas shkollave dhe viteve .....	15
Figura 9: Pajisjet në përdorim nga nxënësit për mësim .....	15
Figura 10: Qasja e nxënësve në internet .....	15
Figura 11: Platforma në përdorim nga nxënësit .....	16
Figura 12: Vlerësimet e nxënësve për mësimdhënien në distancë online .....	17
Figura 13: Kërkesat e nxënësve në lidhje me pasurimin e platformës .....	18
Figura 14: Realizimi i praktikës sipas nxënësve .....	18
Figura 15: Realizimi i praktikës sipas drejtimit të studimeve .....	19
Figura 16: Krahasim i vlerësimeve për mësimin në distancë mes mësuesve dhe nxënësve .....	20
Figura 17: Mendimi i mësuesve për përzgjedhjen e mësimin në distancë .....	40
Figura 18: Metoda e duhur për mësimin online sipas mësuesve .....	40
Figura 19: Pjesëmarrja e nxënësve në sondazh sipas gjinisë .....	41
Figura 20: Pjesëmarrje e nxënësve në sondazh sipas qyteteve .....	41
Figura 21: Mendimi i mësuesve për përmirësimet e mësimin në distancë .....	41
Figura 22: Pjesëmarrja e nxënësve sipas vitit shkollor .....	42
Figura 23: Përzgjedhja e platformës nga nxënësit bazuar në kombinimin e fjalëve kyçe .....	42

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19, qeveria shqiptare, ashtu si edhe në shumë vende të botës, urdhëroi mbylljen e shkollave, fillimisht me afat të kufizuar dhe më pas mbylljen pa afat të tyre. Udhëzimet fillestare të MASR kërkonin që i gjithë sistemi të kalonte *online*, por ende dhe sot mungojnë specifikimet e platformave digjitale gjithëpërfshirëse që të mund të garantojnë mësimdhënie cilësore në këtë situatë. Mbajtja në konsideratë e nevojave specifike të mësuesve dhe të nxënësve lidhur me aksesin në internet dhe pajisjet teknologjike në dispozicion është domosdoshmëri. Pavarësisht sfidave, të gjithë institucionet arsimore publike e private në bashkëpunim edhe me aktorët politikë dhe donatorët kanë reaguar shpejt për të përballuar këtë situatë.

### STUDIMI

Në këtë studim vihen në qendër 10 shkolla<sup>1</sup> të arsimit dhe formimit profesional (AFP) pjesë e projektit “Aftësi për Punë” (S4J) të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Qëllimi kryesor i studimit është të kuptojë, vlerësojë dhe informojë mbi situatën e krijuar në AFP në kushtet e mësimin në distancë. Studimi, i konceptuar si fotografim situatë, fillimisht prezanton masat e ndërmarra në shkollat e AFP për të menaxhuar procesin mësimor, pas diskutimit të metodologjisë vijohet me gjetjet kryesore të sondazheve të kryera me mësues dhe nxënës dhe përmbillet me paraqitjen e rekomandimeve për të përmirësuar situatën e mësimin në distancë për secilën nga palët të përfshira në këtë proces. Në aneks, paraqitet dhe një analizë e thelluar e përdorimit të platformës “MësoVET”, platformë e mbështetur nga projekti “S4J”.

4

### METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Të dhënat u mblodhën nëpërmjet *Google Forms* mes datave 16-20 mars me mësuesit dhe 25-28 mars me nxënësit. Pyetësi iu dërgua të gjithë nxënësve dhe mësuesve dhe u përgjigjën 68% (n=297) e mësuesve dhe 38% (n=2176) e nxënësve. Analiza e të dhënave u bë nëpërmjet programit statistikor SPSS dhe është e natyrës përshkruese. Temat e pyetësit paraqiten të ngjashme midis sondazhit të mësuesve dhe atij të nxënësve duke lejuar krahasueshmëri. Megjithatë sondazhi i nxënësve, për faktin se u krye një javë më vonë dhe për shkak të natyrës dinamike të situatës është më i zgjeruar. Të dhënat e mblodhura shërbejnë përveçse për të monitoruar e dokumentuar të gjithë procesin, dhe si një kornizë për të vlerësuar efektivitetin e metodave dhe platformave të zgjedhura për mësimdhënie në distancë.

### REZULTATE

1. Pjesa më e madhe e mësuesve, 82% (n=242), dhe nxënësve 63.6% (n=1393) e zhvillojnë mësimin në distancë nëpërmjet aplikacionit *WhatsApp*.
2. 77% (n= 229) e mësuesve e vlerësojnë *WhatsApp* si metoda e duhur në këtë situatë, por vetëm 14% e mësuesve që e përdorin mendojnë se kjo është mënyra më rezultative.
3. 11% (n=31) e mësuesve dhe 20% (n = 443) e nxënësve kanë zgjedhur të përdorin platformën “MësoVET” vetëm ose të kombinuar me platforma të tjera digjitale.
4. 15.4% e mësuesve, megjithëse jo të gjithë i përdorin, e vlerësojnë përdorimin e platformave digjitale si *MësoVET* e të tjera si *Google Classroom* apo *NetAcad* si më të efektshme në realizimin e mësimin në distancë *online*.

<sup>1</sup> 9 shkolla janë partnere të projektit S4J dhe 1 shkollë tjetër e përfshirë në studim për qëllime krahasimore.

5. Vetëm 149 nxënës dhe 4 mësues mes alternativave të tjera dhe kombinuar me to kanë zgjedhur dhe orët mësimore në kanalin televiziv shqiptar RTSH.
6. 89% e nxënësve përdorin celularët për të komunikuar dhe siguruar pjesëmarrje në procesin mësimor dhe një pjesë e madhe e tyre shprehen, në pyetjet e hapura, se kjo është e lodhshme duke qenë se janë të detyruar të shpenzojnë shumë orë përpara celularit.
7. Sfidat kryesore të evidentuara nga mësuesit gjatë mësimdhënies në distancë janë: mungesa e materialeve digjitale për 54% (n=157) të mësueve, mungesa e internetit për 27% të mësuesve; dhe mungesa e pajisjeve elektronike e infrastrukturë fizike të përshtatshme për 22.4% të mësuesve.
8. Sfidat kryesore të evidentuara nga nxënësit gjatë mësimin në distancë janë: vështirësi për të kuptuar shpjegimin e mësuesve nga 42% të nxënësve dhe vështirësi për të ndjekur mësimin nga celulari, ndërkohë që 89% e tyre e ndjekin mësimin nëpërmjet celularit.
9. Vetëm 50% e nxënësve shprehen se kanë akses të pandërprerë në internet, ndërkohë 36% e tyre ka akses të kufizuar dhe 14% nuk ka akses në internet.
10. Veçanërisht sfiduese për shkollat e arsimit profesional, për vetë karakterin e tyre, mbetet realizimi i orëve të praktikës profesionale. Gjysma e nxënësve (n = 1088 ) shprehen se praktika profesionale realizohet në kushtet e shtëpisë, 1/3 e tyre (n=725) shprehen se po e realizojnë praktikën përmes projekteve të ndryshme dhe 20% (n = 435) shprehen se praktika profesionale nuk realizohet.
11. 53.8% e mësuesve dhe 43% nxënësve janë të mendimit që mësimi në distancë, përmes platformave digjitale, mund të përdoret edhe pasi shkollat të jenë hapur.
12. Mësuesit dhe nxënësit e vlerësojnë pozitivisht rolin e projektit “Aftësi për Punë” (S4J) në mbështetje të shkollave të tyre dhe sugjerojnë që projekti mund të intensifikojë mbështetjen me më shumë materiale digjitale e mësimore për çdo lëndë, materiale më të shkurtra, mbështetje në pajisje dhe akses në internet, mundësi për ndërveprim online, video etj.

## 2. Hyrje

Në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë globale COVID-19 qeveria e Shqipërisë vendosi mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore në datën 9 mars 2020 për një periudhë dy javore. Ky vendim u rinovua në datën 23 mars dhe aktualisht sistemi arsimor në Shqipëri për shkak të nivelit të lartë të karantimit dhe distancimit social të detyruar do të mbetet mbyllur deri në përfundim të situatës së pandemisë apo vendimit të qeverisë për të rihapur sistemin arsimor në vend. Kjo situatë e izolimit të menjëhershëm në mjedise shtëpie ka dëmtuar, në radhë të parë, përfituesit kryesorë të sistemit arsimor, nxënësit dhe studentët, por njëkohësisht ka sfiduar edhe drejtuesit e kësaj fushe në Shqipëri dhe trupat pedagogjike e drejtuese në arsim. Në këto rrethana ka marrë rol të rëndësishëm parësor krijimi i eko-sistemeve virtuale që mundësojnë mësimin në distancë – strategjia e propozuar nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si përgjigje për të kapërcyer pengesën e ndjekjes fizike të studimeve nëpër institucione arsimore për shkak të karantinës.

Këto zhvillime janë pasqyruar edhe në arsimin dhe formimin profesional (AFP), i cili gjatë dekadës së fundit ka pësuar zhvillime cilësore që kanë sjellë rritjen e numrit të nxënësve të cilët ndjekin arsimin profesional.

Projekti “Aftësi për Punë” mbështet strategjikisht dhe me rritjen e kapaciteteve 10 institucione të AFP-së. Si strategji për të adresuar situatën e mbylljes së shkollave profesionale dhe si pjesë e përpjekjeve për të promovuar të mësuarit online, projekti ka shtrirë dhe intensifikuar ndihmën ndaj mësuesve dhe nxënësve të shkollave partnere të projektit, por dhe më gjerë, për përdorimin e platformës “MësoVET” ([www.mesovet.al](http://www.mesovet.al)), si një mjedis virtual i të mësuarit i zhvilluar nga ky projekt dhe bërë funksional që gjatë vitit 2018.

Për të monitoruar procesin e mësimin në distancë në vazhdimësi, projekti “S4J” ka zhvilluar një kornizë vlerësimi dhe monitorimi të bazuar në sondazhe me nxënës dhe mësues si dhe dokumentim të vazhduar të procesit. Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore të një vlerësimi të shpejtë të situatës bazuar në perceptimet e mësuesve dhe nxënësve. Qëllimet kryesore të raportit janë:

- Të informojë projektin dhe aktorët e interesit lidhur me perceptimet e nxënësve dhe mësuesve mbi mësimin në distancë dhe bazuar në këtë të ndërmarrë masa përmirësuese;
- Të vlerësojë ndërhyrjet e bëra nga projekti në ekosistemin e mësimdhënies lidhur me metodat digjitale të mësimdhënies dhe trajnimin për mësuesit për të përdorur këto metoda;
- Të kuptojë nivelin e përdorimit të platformave të ndryshme të mësimin *online*, angazhimin e palëve në këtë proces, efektshmërinë e mësimin në distancë si dhe mënyrat për përmirësimin e zbatimit të tij;
- Të kuptojë ndryshimet në sjelljen e nxënësve dhe mësuesve, kufizimet dhe vështirësitë siç ato perceptohen prej tyre duke ndihmuar në artikullimin e rekomandimeve për zgjidhje.

### 3. Organizimi i procesit mësimor në distancë

Bazuar në udhëzimin e MASR dhe urdhrin nr. 826 të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), secila shkollë profesionale ka hartuar një plan pune për mësimin në distancë me ndarje detyrash dhe organizimin e ofrimit të mësimin në distancë *online* duke përdorur teknologji digjitale të komunikimit. Urdhrat e brendshëm të drejtorive të shkollave kanë rekomanduar koordinimin e punës përmes organizimit të grupeve në platformën për komunikim social me *WhatsApp*. Grupet ndërtohen nga mësuesit kujdestarë të cilët përcaktojnë edhe formën e komunikimit për të mundësuar hapat e mëtejshëm të zhvillimit të lëndëve bazuar në orarin zyrtar të mësimin<sup>2</sup>.

#### 3.1. Proceset e raportimit dhe vlerësimit digjital në AFP

Procesi i raportimit ka ndjekur një linjë vertikale duke filluar nga mësuesi i lëndës i cili duhet të raportojë për ecurinë e zbatimit të planit për lëndën e tij. Procesi i raportimit për mësimdhënien është i përditshëm dhe për secilën klasë bëhet nga mësuesi kujdestar i cili raporton me shkrim përmes postës elektronike që i dërgohet drejtorit dhe nëndrejtorit. Nëndrejtori përgatit një raport të përmbledhur ditor, i cili me udhëzimin nr. 9 (23.03.2020) është njësuar në formë dhe dërgohet pranë AKPA-s. Shkollat po përgatisin edhe raporte cilësore për AKPA-n në lidhje me ecurinë e procesit mësimor në tërësi dhe me informacion të detajuar për shkallën e realizimit të planit mësimor. Ky raport pritët të dorëzohet deri në datën 3 prill 2020.




Figura 1: Elementet e raportimit për mësimin në distancë në përdorim në AFP

Monitorimi i procesit mësimor realizohet kryesisht përmes shkëmbimeve në postë elektronike. Mësuesit raportojnë me anë të një formati të dakortësuar më parë. Janë në përdorim edhe formate apo platforma që i lejojnë drejtorisë së shkollës pjesëmarrjen në një orë mësimore *online*.

Vlerësimi i nxënësve bëhet përmes formave lehtësisht të dokumentueshme që përfshijnë:

- ✓ detyra të dërguara në *WhatsApp* apo e-mail;
- ✓ mini-teste nëpërmjet platformës;
- ✓ quiz-e me përgjigje të shumëfishta;
- ✓ testeve në *Google Forms* etj.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve<sup>3</sup> (AKAFPK) por edhe MASR në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) kanë nxjerrë udhëzuesit respektivë për *realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në*

<sup>2</sup> Informacioni në këtë seksion bazohet mbi të dhënat e mbledhura nëpër shkollat, pjesë e projektit “Aftësi për Punë” S4J, dhe pasqyron hapat që janë ndërmarrë për të krijuar mundësi për procesin mësimor në distancë duke përdorur teknologjitë digjitale.

<sup>3</sup> <http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/Udhezues-Mesimi-e-vleresimi-online-ne-AP-.pdf>



*kushtet e shtëpisë*<sup>4</sup> ku udhëzohet se vlerësimi do të bazohet në mbajtjen e shënimeve nga ana e mësuesve për secilin nxënës dhe orientimin drejt punës individuale dhe të diferencuar të nxënësve apo vlerësimin me portofola apo testime të ndryshme. Udhëzimi i AKAFPK rekomandon përdorimin e platformës MësoVET për shkollat profesionale. Edhe pse është arritur që procesi mësimor të ruajë një farë vazhdimësie dhe të marrë veten nga ndërprerja e menjëhershme e tij, hasen probleme në realizimin e orës cilësore të mësimin, zhvillimin e praktikave, sigurimin e ndjekjes së orës së mësimin nga të gjithë nxënësit dhe kontrollin e dijeve.

### 3.2. Platformat në përdorim për mësimin në distancë

**WhatsApp:** Që në fillim të këtij studimi është vënë re përdorimi i platformës së komunikimit *WhatsApp* për të mundësuar procesin mësimor në distancë. Ajo po përdoret gjerësisht nga mësuesit dhe drejtoritë e shkollave për të organizuar proceset e mësimin në distancë. Kjo platformë po përdoret si në proceset e komunikimit për orën e mësimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e punës së nxënësve, por edhe si formë komunikimi mes stafit pedagogjik dhe drejtorisë.

**MësoVET.al,** platforma digjitale e mbështetur nga projekti “Aftësi për Punë”, hyn në platformat e rekomanduara nga AKPA dhe AKAFPK për zhvillimin e mësimin në distancë dhe përdorimi i saj është në rritje. Në platformë janë hedhur tashmë temat e mbetura pa zhvilluar si edhe programet e orientimit për maturanët. Platforma po përdoret dhe për vlerësimin e nxënësve përmes testeve dhe quiz-eve. Bashkëpunimi i mësuesve, si me njëri-tjetrin dhe me projektin, ka siguruar kthimin e platformës në një instrument të shpejtë dhe cilësor për zhvillimin e mësimin në distancë.

**Platforma të tjera** digjitale në përdorim janë ato të bazuara në teknologjitë *Google*, si: *Classroom*, *Meet*, *Forms etj.* Po ashtu përdoret edhe platforma *NetAcad* pjesë e rrjetit CISCO.

---

<sup>4</sup> <https://arsimi.gov.al/udhezues-per-mesimin-ne-kushtet-e-shtepise-per-shkak-te-situates-se-krijuar-nga-perhapja-e-virusit-covid-19/>

## 4. Metodologjia e sondazheve dhe e studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të monitorojë procesin e mësimin në distancë në institucionet e AFP të përfshira në projektin “Aftësi për Punë” (S4J), të cilat janë të përhapura në mbarë vendin. Synim kryesor mbetet mbledhja e të dhënave të sakta statistikore në fillimet e periudhës së mësimin në distancë. Të dhënat do të përdoren më pas si një bazë, jo vetëm për të analizuar situatën aktuale por edhe për të zhvilluar analiza krahasuese në vijim. Kjo do t'i shërbejë procesit të krijimit të një ekosistemi që ushqen të mësuarin digjital në vazhdimësi, duke qenë se kjo situatë do të vazhdojë por edhe sepse i mësuarin digjital është një realitet që nuk mund të anashkalohej.

Përveç qëllimeve të shprehura në hyrje të këtij studimi, sondazhet japin mundësi për përpunim të thellë statistikor të informacionit që grumbullohet. Duke vënë në përdorim programe *software* për përpunimin e të dhënave statistikore si *Excel* dhe *SPSS*, studimi synon të arrijë edhe disa qëllime me natyrë analitike:

- ❖ Të analizojë metodat që po përdoren për të realizuar mësimdhënien online në AFP;
- ❖ Të kuptojë përvojën e mësuesve dhe nxënësve në angazhimin arsimor në kushtet e shtëpisë;
- ❖ Të grupojë dhe analizojë platformat dhe pajisjet digjitale në përdorim nga mësuesit dhe nxënësit;
- ❖ Të kuptojë sfidën e realizimit të praktikës profesionale (thelbërsor për AFP) gjatë mësimin në distancë;
- ❖ Të zbulojë sfidat dhe sugjerimet në sondazhe në lidhje me mësimdhënien në distancë.

Ato përbëjnë edhe pikat kryesore të analizës në këtë studim, të cilat besohet se do të ndihmojnë si projektin “Aftësi për Punë” dhe politikë-bërësit në AFP për të ndërmarrë hapa të informuar në përmirësimin e mëtejshëm të situatës krijuar nga sfida e karantimit prej COVID-19.

### 4.1. Pjesëmarrja në sondazhe

Në këtë studim u tuan të marrin pjesë të gjithë mësuesit (n=434) dhe nxënësit (n=5729) në 10 shkolla të arsimit profesional me të cilat bashkëpunon projekti “Aftësi për Punë”. Këto shkolla gjeografikisht janë të shpërndara në të gjithë vendin dhe mbulojnë degë e profile nga më të larmishmet në AFP. Shkollat pjesëmarrëse në këtë studim ishin nga Tirana - 2; nga Shkodra - 1, nga Berati - 2, nga Lezha - 1, nga Vlora - 2 dhe nga Elbasani - 2 . Të gjitha shkollat janë të sistemit të mesëm 4-vjeçar dhe studimet mbylleen me provime të maturës shtetërore dhe provime të tjera kualifikuese sipas drejtimit të studimeve.

#### Pjesëmarrja e mësuesve në sondazh

Gjithsej morën pjesë 68% e mësuesve (n=294). Numri pjesëmarrës i mësuesve në studim ishte përfaqësues për secilën shkollë dhe përputhej mirë me numrin e mësuesve për shkollë në popullatë. Niveli i përfaqësimit për secilën shkollë ndryshonte nga 31% (Kristo Isak) në 95% (Stiliano Bandilli).

Tabela 1: Pjesëmarrja e mësuesve në sondazh sipas shkollave dhe në raport me popullatën e mësuesve

PJESËMARRJA E MËSUESVE SIPAS SHKOLLAVE	kampioni		popullata *	
	Nr	%	Nr.	%
1. Shkolla Teknike Elektrike “Gjergj Canco”, Tiranë	33	11.2	49	11.7
2. Shkolla e mesme teknologjike “Hamdi Bushati”, Shkodër	12	4.1	38	9

3. Shkolla e mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Lezhë	34	11.5	47	11.2
4. Shkolla profesionale “Kristo Isak”, Berat	8	2.7	26	6.2
5. Shkolla Tregtare, Vlorë	21	7.1	25	6
6. Shkolla profesionale “Salih Çeka”, Elbasan	30	10.2	44	10.5
7. Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë	62	21	66	15.7
8. Shkolla e mesme profesionale “Ali Myftiu”, Elbasan	28	9.5	52	12.4
9. Shkolla industriale “Pavarësia”, Vlorë	30	10.2	49	11.7
10. Shkolla profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat <sup>5</sup>	36	12.2	38	9
<b>Total</b>	<b>258</b>	<b>100</b>	<b>396</b>	<b>103</b>
*numri i mësuesve është llogaritur duke hequr stafin mbështetës				

### Pjesëmarrja e nxënësve në sondazh

Gjithsej morën pjesë 38% e nxënësve (n=2176). Duke pasur parasysh numrin e madh të popullatës dhe përqindjen e mirë por më të ulët të përgjigjeve të nxënësve dhe me qëllim pasjen e të dhënave më përfaqësuese për të gjitha shkollat, të dhënat u peshuan statistikisht duke mbajtur në konsideratë numrin dhe përqindjen e nxënësve për çdo shkollë. Në tabelën më poshtë paraqitet numri dhe përqindja e nxënësve në popullatë dhe në kampion para dhe pas peshimit.

Tabela 2: Numri i nxënësve në sondazh sipas shkollave dhe në raport me popullatën e nxënësve

NXËNËSIT	KAMPIONI (n)				POPULLATA (N)	
	Para peshimit		Pas peshimit			
	NR	%	NR	%	NR	%
1. Shkolla Teknike Elektrike Gjergj Canco, Tiranë	444	20.4	311	14.2	786	13.7
2. Shkolla e mesme teknologjike Hamdi Bushati, Shkodër	162	7.4	243	11.1	652	11.4
3. Shkolla e mesme profesionale Kolin Gjoka, Lezhë	235	10.8	212	9.7	532	9.3
4. Shkolla profesionale Kristo Isak, Berat	77	3.5	77	3.5	199	3.5
5. Shkolla e mesme Tregtare, Vlorë	80	3.7	120	5.5	322	5.6
6. Shkolla profesional Salih Ceka, Elbasan	184	8.5	221	10.1	600	10.5
7. Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë	489	22.5	342	15.6	898	15.7
8. Shkolla e mesme profesionale Ali Myftiu, Elbasan	216	9.9	302	13.8	792	13.8
9. Shkolla industriale Pavarësia, Vlorë	202	9.3	222	10.1	589	10.3
10. Shkolla profesionale Stiliano Bandilli, Berat	87	4.0	139	6.4	359	6.3
<b>GJITHSEJ</b>	<b>2176</b>	<b>100</b>	<b>2189</b>	<b>100</b>	<b>5729</b>	<b>100</b>

## 4.2. Instrumentet

Për realizimin e këtij raporti u realizuan dy sondazhe: një me mësuesit dhe një me nxënësit. Të dy pyetësorët u hartuan dhe u administruan nëpërmjet platformës *Google Forms*. Fillimisht u realizua sondazhi i mësuesve, në datat 16 - 20 Mars, 2020 dhe në datat 25 - 28 Mars 2020 me nxënësit. Pyetësori me mësuesit përfshinte 9 pyetje të cilat i kërkonin atyre vlerësim për mësimdhënien gjatë kësaj periudhe duke përfshirë pyetje për platformat që po përdorin për realizimin e mësimin dhe format e cilësinë e lidhjes që përdoret për të realizuar mësimin.

<sup>5</sup> Shkolla “Stiliano Bandilli” nuk mbështetet nga projekti S4J. Përfshirja e saj në këtë studim është bërë për qëllime krahasimore.

Pyetësoi me nxënësit përfshin rreth 32 pyetje të ngjashme me pyetjet e mësuesve që i kërkonte atyre të vlerësonin procesin e mësimdhënies në distancë gjatë kësaj periudhe. Nxënësve ju kërkua të vlerësonin procesin në lidhje me platformën e përdorur, pajisjet që përdornin për të ndjekur mësimin, qasjen në internet, dhe një sërë pohimesh të lidhura me elementë të ndryshëm të procesit dhe që vlerësoheshin në një shkallë nga 0 = plotësisht jo dakord në 4 = plotësisht dakord. Të dhënat u përpunuan me paketën statistikore *SPSS*. E gjithë analiza e është e natyrës përshkruese pasi vetë instrumenti u ndërtua në mënyrë të atillë për të faktuar situatën.

#### **4.3. Konsiderata etike**

Të gjitha hulumtimet e ndërmarra në kuadër të këtij studimi, intervistat dhe bisedat e bëra janë bërë në përputhje me parimet etike dhe në respektim të kodit të sjelljes së *Swisscontact*. I gjithë informacioni i mbledhur nga sondazhet dhe bisedat është përdorur vetëm në kuadër të tij dhe për llogari të projektit "S4J". Të gjithë të intervistuarit ishin në dijeni të temës së bisedës dhe informacionin e ndanë hapur e pa asnjë lloj hezitimi. Sondazheve iu paraprin një hyrje e cila shpjegon qëllimet e sondazhit dhe siguron si nxënësit dhe mësuesit për respektimin dhe ruajtjen e të dhënave apo për mos mbledhjen e të dhënave personale. Në asnjë prej sondazheve nuk u mbledhën të dhëna të identifikueshme dhe pjesëmarrësit. Ata u informuan në lidhje me përdorimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre. Studiuesit e përfshirë nuk kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë as me nxënësit dhe as me mësuesit e shkollave të përfshira në sondazh. Informacionet e tjera në lidhje me mbarëvajtjen e mësimdhënies u siguruan nga projekti "S4J" dhe personeli drejtues në shkollat pjesëmarrëse.

#### **4.4. Kufizimet e studimit**

Të dhënat e këtij studimi përfaqësojnë mendimet dhe përvojat e pjesëmarrësve në studim. Për më tepër, kampioni i përzgjedhur është përfaqësues vetëm për mësuesit dhe nxënësit në shkollat partnere të projektit S4J. Pavarësisht se kampioni i mësuesve është i konsiderueshëm në raport me popullatën, analiza sipas grupeve duhet detajuar sipas kontekstit specifik të shkollave dhe drejtimeve që ato mbulojnë. Të dhënat e nxënësve u peshuan vetëm për numrin e nxënësve për shkollë, por ndërkohë ka shumë variacion mes shkollave sa i takon shtrirjes gjeografike, drejtimeve e profileve të secilës shkollë apo edhe diversitetit lidhur me mësuesit, nxënësit, komunitetin, etj.

## 5. Rezultatet dhe analiza e sondazheve

### 5.1. Rezultatet nga sondazhi me mësues

Mësuesit që morën pjesë përfaqësojnë rreth **68%** të numrit të përgjithshëm të mësuesve që japin mësim në këto 10 shkolla. Shumica dërrmuese e tyre, **86%**, mendojnë se mësimi në distancë bazuar në teknologjitë *online* është zgjidhja e duhur për mësimdhënien kur shkollat janë fizikisht të mbyllura. Pjesa që e kundërshton këtë mendim (**11%**) shprehet kryesisht se më efikas është zëvendësimi i të shtunave dhe të dielave pasi të hapen shkollat, kurse pjesa tjetër mendon që duhet pritur sa të hapen sërish shkollat e të përfundojë karantina.




Figura 2: Vlerësimet e mësuesve për situatën e mësimin në distancë

Vështirësia kryesore që has më shumë se gjysma e mësuesve është fakti që nxënësit nuk kanë internet dhe pajisje për të realizuar komunikimin dhe mësimin në distancë. Një pjesë tjetër e mësuesve, vlerësojnë ndërveprimin e krijuar dhe interesin e treguar nga të gjitha palët (**16%**) dhe interesin e treguar si nga nxënësit dhe nga prindërit (**11%**). Meqenëse projekti S4J i ka pajisur pothuajse të gjithë mësuesit me *laptop*-ë, mungesa e pajisjeve për mësuesit nuk duket se përbën problem. Ndërkohë ka dalë si sfidë trajnimi i tyre me aftësi digjitale të mësimdhënies.




Figura 3: Aplikacioni ose platforma në përdorim nga mësuesit

Pak më shumë se 8 në çdo 10 mësues përdorin aplikacionin *WhatsApp* dhe pak prej tyre përdorin platforma si "MësoVet". Herë pas here vihet re edhe kombinimi i platformave të mësipërme me *Google Classroom*. Mësuesit kanë zgjedhur *WhatsApp* sepse ajo është metoda më e lehtë për t'u përdorur si për komunikim të zakonshëm dhe për të kryer ngarkesën mësimore. Gjithashtu, përdorimi i grupeve të *Whatsapp* u theksua në udhëzimin fillestar nga MASR. Mësuesit janë të bindur (77 %) se *WhatsApp* është metoda e duhur për të realizuar mësimin në distancë në këtë situatë. Kjo ndiqet nga mësimi përmes platformës "MësoVet" dhe të ngjashmet me të (11%) për të vijuar me mësimin përmes orëve televizive në RTSH apo metoda të tjera (14%)

Mësuesit shprehen se zgjedhja e metodës së duhur bazohet në lehtësinë e përdorimit të saj nga nxënësit, në besimin se metoda e zgjedhur është më rezultativja apo se kjo është metoda e sugjeruar nga shkolla. Një pjesë më e vogël (4.1%) shprehen se kanë zgjedhur metodën që ata njohin më mirë.




Figura 4: Arsyet e mësuesve për përdorimin e metodës së zgjedhur

Sfida më e madhe për më shumë se çerekun e tyre, sipas grafikut më poshtë, mbetet mungesa e internetit e pasuar nga vështirësitë në vlerësim dhe monitorim dhe mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të mësuesve nuk del si problem për mbarëvajtjen e mësimin *online* – më pak se 0.3%.




Figura 5: Sfidat e mësuesve për mësimin në distancë online

Mësuesit e vlerësojnë pozitivisht rolin e projektit "S4J" në mbështetje të shkollave të tyre dhe të pyetur ne sondazh në lidhje me çfarë mendonin se mund t'i ndihmonte projekti një pjesë e konsiderueshme (15%) shprehen se projekti ka bërë mjaftueshëm për t'i mbështetur. Disa u shprehën se: "Projekti ka bërë mjaftueshëm duke vënë në dispozicion platformën "MësoVet"<sup>6</sup> dhe të tjerë mendojnë se "Në këtë pikë nuk ka gjë tjetër që projekti mund të ofrojë. I mundëson vetë platforma MësoVet". Të tjerë mësues, gati një e treta, shprehen se projekti mund t'i ndihmojë me më shumë materiale mësimore digjitale dhe të tjerët kërkojnë trajnime të ndryshme për t'u zhvilluar




Figura 6: Kontributi i mëtejshëm i projektit "S4J" sipas mësuesve

profesionalisht për mësimin në distancë. Kjo përbën një situatë që duhet hetuar më tej sepse në pyetjen e mësipërme mësuesit nuk mendojnë se kanë nevojë për rritje të kapaciteteve të tyre. Kur kjo nevojë paraqitet si diçka që mund të ofrohet nga projekti, numri i personave që shprehen të interesuar për trajnime të mëtejshme rritet.

Përpos sfidave gjatë kësaj periudhe, më shumë se gjysma e mësuesve janë të mendimit që mësimi në distancë *online* mund të jetë një metodë që mund të aplikohet edhe në të ardhmen, kur shkollat të hapen.




Figura 7: Vazhdimi me mësimin në distancë edhe më pas

<sup>6</sup> Citimet të drejtëpërdrejta nga takime me mësues të organizuar nga projekti "S4J" në kuadër të angazhimit për zhvillimin e arsimit në kushtet e karantinës.

## 5.2. Rezultatet nga sondazhi me nxënës

Sondazhi qëndroi i hapur gjatë javës së fundit të marsit dhe pjesëmarrja ishte gati **40%** e numrit të përgjithshëm të nxënësve që ndjekin mësim profesional në këto 10 shkolla, pra **2176** nxënës. Grafiku në vijim i paraqet pjesëmarrësit të ndarë sipas shkollave dhe klasave.




Figura 8: Nxënësit në sondazh sipas shkollave dhe viteve

Të dhënat për qasjen e vazhdueshme në internet korrespondojnë me të dhënat kombëtare për qasjen në internet në qytete, dhe tregojnë se gjysma e nxënësve kanë internet të vazhdueshëm. Ndërkohë, është këmbanë alarmi fakti që gjysma tjetër ose e kanë internetin me raste ose nuk kanë fare qasje në të. 14% të nxënësve në këtë sondazh nuk kanë akses në internet. Nga ana tjetër, shqetësimi thellohet kur shikon se në çdo 10 nxënës 9 prej tyre përdorin celularin për të zhvilluar mësimin në distancë në kushtet e shtëpisë.

15



Figura 10: Qasja e nxënësve në internet




Figura 9: Pajisjet në përdorim nga nxënësit për mësim

Më pak se 10% e nxënësve që morën pjesë në sondazh arrijnë ta ndjekin mësimin me laptop. Po ashtu dihet që sukcesi i platformave digjitale të mësimdhënies fillon me krijimin e bazës materiale që të



mundësojë ndjekjen e mësimit nëpërmjet këtyre platformave. Kështu do të mund të realizohej mësim digjital i aplikuar e jo shkëmbime në aplikacione komunikimi.

Më shumë se 6 në 10 nxënës theksojnë se po mësojnë kryesisht përmes aplikacionit të komunikimit *WhatsApp*. Në sondazh ata u pyetën edhe për platforma të tjera dhe mësimin përmes kanalit televiziv RTSH. Këtu dominon platforma “MësoVET” me 12% të përgjigjeve, e ndjekur nga *Google Classroom*. Një analizë më e thelluar për përdorimin e kësaj platforme paraqitet në aneksin 8.1 të këtij studimi. Shumë pak nxënës i ndjekin programet e RTSH-së (3%), dhe kjo mund të ketë lidhje edhe me faktin se ky televizion nuk ofron programe specifike për arsimin profesional. Një pjesë e tyre shprehen se përdorin një kombinim platformash.




Figura 11: Platforma në përdorim nga nxënësit

Në ndryshim nga mësuesit, nxënësve iu kërkua që opinionet e tyre t’i jepnin duke shprehur miratimin apo mosmiratimin e tyre për 19 fjali deklarative. Këto fjali kishin karakter cilësor dhe u kërkonin atyre të vlerësonin pothuajse të gjitha aspektet e procesit mësimor në distancë *online*. Opinionet e tyre të përshkallëzuara nxënësit duhet t’i shprehnin duke zgjedhur vetëm njërën prej alternativave sipas shkallës në vijim, ku “0” (zero) përfaqëson mungesën totale të miratimit dhe “4” nivelin më të lartë të miratimit: 0 = plotësisht jo dakord; 1 = jo dakord; 2 = deri diku dakord; 3 = shumë dakord; 4 = plotësisht dakord.

Në grafikun që pason, përgjigjet nxënësve janë renditur sipas peshës pozitive që ato kanë pasur për secilën pyetje. Duket qartë që nxënësit vlerësojnë pozitivisht pjesëmarrjen në diskutime, shpjegimet e mësuesve, materialet e shpërndara me *WhatsApp* dhe gjuhën e përdorur në diskutime, ndërsa vlerësojnë më pak ndikimin në mësimnxënie të mësimit në distancë dhe vazhdimin të përdorimit të tij për të ardhmen.

## MENDIMET E NXËNËSVE PËR MËSIMDHËNIEN NË DISTANCË ONLINE




Figura 12: Vlerësimet e nxënësve për mësimdhënien në distancë online

Vlen të theksohet se në përgjithësi vlerësimet e nxënësve anojnë nga ana e miratimit të lartë për pjesën më të madhe të pyetjeve të bëra. Duket kështu që nxënësit e kanë pranuar realitetin e të mësuarit nga shtëpia dhe se ata po bëjnë përpjekje për ta “normalizuar” procesin. Nga ana tjetër, shpjegimet *online* mbeten sfidë për 60% të nxënësve që morën pjesë në sondazh.

Lidhur me pasurimin me materiale të platformës digjitale, nxënësit theksuan nevojën e shtimit të materialeve mësimore për çdo lëndë. Gjithashtu, ata u shprehën se materialet duhet të jenë të shkurtra e të përshtatshme për t’u lexuar nga celularët. Më shumë së gjysma e nxënësve shprehën

qartë për nevojat për materiale me qasje digjitale dhe ndërvepruese. Pjesa tjetër e kërkesave për platformat ka të bëjë me rritjen e sasisë së videove mësimore që në këto kushte mund të zëvendësojë praktikën. Për t'u theksuar është fakti që 1 në 4 nxënës kërkon më shumë hapësirë për diskutim *online*, gjë që përmes celularit është një sfidë për t'u realizuar.




Figura 13: Kërkesat e nxënësve në lidhje me pasurimin e platformës

Pyetjes së hapur lidhur me mënyrën se si po vlerësohen nga mësuesit, në gati gjysmën e rasteve nxënësit përmendin përdorimin e pyetjeve të hapura dhe detyrave në formë projekti. Pjesa tjetër e përgjigjeve ndahet mes testimeve në formë *quiz*-i dhe punës me grupe.




Figura 14: Realizimi i praktikës sipas nxënësve

Sfida e heshtur gjatë kësaj situatë me arsimin e formimin profesional lidhet me praktikën profesionale. Gjysma e nxënësve pohojnë se po e realizojnë praktikën në kushtet e shtëpisë, ndërsa **gati 1/3** përmes projekteve të ndryshme. 20% thonë se praktika nuk po realizohet. Më shumë se gjysma e nxënësve janë të kënaqur me gjetjen e zgjidhjes për realizimin e praktikës profesionale ndërsa 1/4 e tyre nuk janë dakord me zgjidhjen e ofruar për praktikën.

Për të kuptuar më shumë mbi realizimin e praktikës profesionale në kushtet e mësimit në distancë *online* u kryqëzua pyetja për realizimit të orëve të praktikës me drejtimin e studimeve të nxënësve. Drejtimet që kanë përqindjen më të lartë të nxënësve që deklarojnë se nuk po e kryejnë praktikën profesionale janë (në rend zbritës): Teknologji ushqimore 50%<sup>7</sup>; Shërbime sociale dhe shëndetësore (SHSSH) 35% (n=12); Elektroteknikë integruar me elektronikë 30% (n=11), Elektroteknikë (26% n=65), Mekanikë 17% (n=25). Më mirë paraqiten drejtimet: Tekstil-konfeksione, Ndërtim, Shërbime transporti e logjistikë (SHMT), Instalues i sistemeve termo-hidraulike (ISTH). Të dhëna më të detajuara për secilin drejtim gjenden në aneksin 8.2.




Figura 15: Realizimi i praktikës sipas drejtimin të studimeve

Nxënësit në shkollën “Kolin Gjoka” në Lezhë përbëjnë përqindjen më të madhe të atyre që raportojnë se nuk po e realizojnë praktikën me 35% (n=75), më pas vijnë nxënësit e shkollës “Gjegji Canco” në Tiranë me 25% (n=77) dhe nxënësit e shkollës “Ali Myftiu” në Elbasan me 18% (n=54). Përqindjen më të ulët të e zënë nxënësit e shkollës “Salih Çeka” në Elbasan, ku vetëm 9% (n=19) deklarojnë se nuk po i realizojnë orët e praktikës profesionale<sup>8</sup>.

Në sondazh, **860** nxënës kanë zgjedhur të japin mendimet e tyre të lira në lidhje me mësimin në distancë. Ajo që vihet re në këtë masë që përfaqëson thuhetse **40%** të nxënësve pjesëmarrës në sondazh, është pozitiviteti për të përballuar situatën e krijuar. Nuk mungojnë edhe kritikata e vlefshme të cilat janë vendosur në aneksin 8.4. Siç del edhe nga pyetjet e karakterit cilësor, në shumicën e rasteve nxënësit janë pajtuar me të mësuarin *online*, përjashtojnë testimet dhe shqetësimin e maturantëve për provimet përfundimtare. Vështirësia kryesore lidhet me faktin se *nuk mund të behet*

<sup>7</sup> Numri i nxënësve nga ky drejtim është i kufizuar dhe 4 nga 8 shprehen se nuk kanë kryer praktikën.

<sup>8</sup> Të dhënat më të detajuara janë vendosur në tabelat në aneksin 8.2.

mësim me celular dhe nuk mund te lexohet nga celulari çdo gjë. Ka një grup komentesh që theksojnë se kjo metodë nuk po funksionon, siç ka edhe shumë falënderime për organizimin dhe konsideratën për mendimet e tyre.

### 5.3. Krahasime mes perceptimeve të mësuesve dhe nxënësve

**56%** e mësuesve që morën pjesë në sondazh vlerësojnë mungesën e internetit si pengesën kryesore për mbarëvajtjen mësimin në distancë *online*. Nga ana tjetër, rezulton se vetëm **50%** e nxënësve kanë internet gjatë gjithë kohës, **36%** kanë internet me raste dhe vetëm **14%** e tyre nuk kanë fare akses në internet. **82%** e mësuesve dhe **64%** e nxënësve thonë se përdorin *WhatsApp* për të bërë mësim. **15.4%** e mësuesve e vlerësojnë përdorimin e platformave digjitale si “MësoVET” si të efektshme në realizimin e mësimin në distancë, ndërkohë që pasi u kombinuan përgjigjet<sup>9</sup> u vu re që platformën e përdorin vetëm **11%** (n=31) e mësuesve, kjo e kombinuar me metoda e platforma të tjera. Ndërkohë përqindja e nxënësve që e përdorin platformën vetëm ose të kombinuar me platforma të tjera është **20%** (n=443).

Si mësuesit dhe nxënësit shohin si sfida kryesore mungesën e materialeve të përshtatshme për të zhvilluar mësim *online*, respektivisht në masën **15.3%** dhe **14%**. Ndërsa **70%** e nxënësve janë dakord me formën se si po vlerësohet mësimi *online* (pyetje frontale, etj.), **20%** e mësuesve e kanë problem vlerësimin në këtë format. **39%** e mësuesve dhe **54%** e nxënësve janë dakord që kjo formë e mësimdhënies të vazhdojë të shfrytëzohet edhe pas mbarimit të karantinës.




Figura 16: Krahasim i vlerësimeve për mësimin në distancë mes mësuesve dhe nxënësve

<sup>9</sup> U llogaritën përgjigjet e mësuesve dhe nxënësve duke mbledhur edhe rastet kur të intervistuarit e kanë përmendur përdorimin e platformës si të vetme apo në kombinim me metoda e platforma të tjera

## 6. Konkluzione

Bazuar në të dhënat e dy sondazheve të analizuara në këtë studim rezulton se:

- ❖ Nxënësit dhe mësuesit duken se e kanë pranuar si zgjidhjen më të mirë realizimin e procesit mësimor nëpërmjet mësimin në distancë në situatën e krijuar nga mbyllja e shkollave dhe izolimi brenda shtëpive.
- ❖ Procesi mësimor po realizohet kryesisht duke përdorur aplikacionin *WhatsApp*. Janë vënë në përdorim edhe platforma digjitale si “MësoVET” apo *Google Classroom* që kombinohen me këtë aplikacion, siç tregohet edhe në figurën 11 apo në aneksin 8.1, por në përqindje të ulëta.
- ❖ Ndërhyrjet e bëra nga projekti “S4J”, si me platformën “MësoVET” dhe me trajnimin dhe mbështetjen e mësuesve, ka ndikuar pozitivisht dhe i ka gjetur shkollat partnere të projektit më të përgatitura në përballimin e kësaj situatë.
- ❖ Përdorimi masiv i platformave digjitale të mësimin në distancë *online* kërkon ende shumë punë dhe angazhim të palëve në këtë proces, edhe gjatë periudhave normale të mësimin.
- ❖ Mësimin në distancë *online* është i realizueshëm kur palët janë të angazhuara, por efektshmëria do të ishte më e lartë nëse aftësitë digjitale mësimdhënëse dhe mësim-nxënëse do të ishin formësuar më parë.
- ❖ Sjellja e mësuesve dhe nxënësve po ndryshon dhe po i përshtatet realitetit të mësimin nga shtëpia.
- ❖ Mungesa e pajisjeve elektronike dhe mbështetja në internet të vazhdueshëm e dobësojnë cilësinë e mësimin në distancë *online* dhe sfidojnë proceset e vlerësimit të nxënësve.
- ❖ Mungesa e materialeve mësimore digjitale është ndër pengesat kryesore, të artikuluar nga mësuesit, për përdorimin e platformave digjitale.
- ❖ Nevoja për implementim të menjëhershëm të mësimin në distancë *online* evidentoi domosdoshmërinë për digjitalizimin dhe inovacionin të sistemit arsimor, atij profesional dhe jo vetëm.

## 7. Rekomandime

Bazuar në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të mësimin në distancë, u identifikuan rekomandimet e mëposhtme:

### Politikë-bërje:

- a. Aftësimi për mësimdhënie *online* duhet të jete pjesë integrale e procesit të trajnimit të mësuesve aktualë dhe të ardhshëm;
- b. Trajnimet për mësimdhënien në distancë që i ofrohen arsimit të përgjithshëm duhet të jenë të hapura edhe për mësuesit në arsimin profesional;
- c. Investim në kapacitimin e mësuesve për menaxhimin e mësimin përmes platformave digjitale *online* në mënyrë që ata të jenë të aftë për ta përdorur edhe më tej përvojën e fituar
- d. Duhet të përgatiten dhe të vihen në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve materiale mësimore dhe testimi për maturën me video dhe ushtrime në format digjital;

- e. Duhet investuar në infrastrukturë digjitale për shkollat profesionale të përballuar mësimdhënien në distancë *online*;
- f. Mësimdhënia në distancë duhet të shoqërohet me udhëzime për një sistem të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi që procesi të përmirësohet për të gjithë;
- g. Adresim në kohë reale i qasjes së kufizuar në internet dhe infrastrukturë për një kategori të nxënësve dhe mësuesve;
- h. Investim real në platformat digjitale dhe materiale mësimore digjitale në gjuhën shqipe;
- i. Orientimi i nxënësve dhe mësuesve drejt platformave digjitale të njohura dhe lehtësisht të arritshme.

#### **Projekti “S4J”:**

- a. Fuqizim i platformës MësoVET dhe përmirësimi i eksperiencës së përdoruesve;
- b. Përfshirja e shkollave të ndryshme, duke krijuar grupe pune dhe mekanizma mbështetës për zhvillimin e materiale digjitale mësimore;
- c. Angazhim të nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore për zhvillimin e praktikave profesionale në kushtet e shtëpisë;
- d. Aftësim i mësuesve të AFP-së për zhvillimin dhe planifikimin e mësimin në distancë bazuar në përgatitjen e një moduli trajnimi digjital për mësuesit për metodat dhe mësimdhënien digjitale në distancë;
- e. Pasurimi i platformës “MesoVET” me materiale mësimore digjitale duke u fokusuar tek materialet për maturën shtetërore.

#### **Shkollat partnere**

- a. Përshtatja e planit mësimor për zhvillimin e mësimin në distancë;
- b. Përfshirja e trajnimeve mbi aftësitë digjitale për mësimdhënie në planet e zhvillimit të vazhduar profesional të çdo mësuesi;
- c. Zhvillimi i materialeve mësimore digjitale ndërrvepruese nga mësuesit dhe ngarkimi i tyre në platforma;
- d. Përdorimi i formateve të përshtatshme të vlerësimit, si: *Google Forms* etj.;
- e. Dokumentimi i procesit dhe zhvillimi i instrumenteve raportues dhe matës për mësimin gjatë kësaj situate;
- f. Krijimi i komuniteteve të praktikës për të ndarë eksperiencat dhe bërë mentorim mes mësuesve.

#### **Nxënësit / prindërit**

- a. Angazhim dhe bashkëpunim me shkollat për të rritur pjesëmarrjen;
- b. Krijimi i grupeve të mësimin bazuar në përdorimin me orar të një *laptop*-i nga disa nxënës për të larguar varësinë nga celulari;
- c. Krijimi i mekanizmave të *feedback*-ut dhe propozimeve për përmirësim koordinuar nga Qeveria e Nxënësve dhe Komiteti i Prindërve;
- d. Përdorim dhe nxitje e metodave të punës përmes *WhatsApp* dhe më shumë drejt platformave si “MësoVET”.



# ANEKSE



## 8. Anekse

### 8.1. Rast studimi: Platforma digjitale “MësoVET”

Përpara se të hyjmë në një analizë statistikore të detajuar të të dhënave të mbledhura nga nxënësit në raport me përdorimin e platformës digjitale “MësoVET”, duhet bërë një parantezë rreth saj. Që në fillimet e veta, projekti “S4J” ka mbështetur platformat digjitale të menaxhimit të mësimi<sup>10</sup>, të provuara si të suksesshme për kombinimin e të nxënës ballë për ballë me atë *online*. Dy platforma të tilla kanë rezultuar të vlefshme për AFP-në dhe po përdoren edhe tani në mbështetje të mësimi në distancë.

**Platforma “MësoVet”** ka 3057 përdorues, nga të cilët 138 mësues. Platforma ka gjithsej 85 lëndë, nga të cilat 69 profesionale e me hapësirë virtuale për materiale mësimore, detyra e testime, për drejtimet “TIK”, “Hoteleri-Turizëm”, “Ekonomi”, “Shërbime mjetesh transporti”, “Tekstil-Konfeksione”, “Mekanikë”, “Elektroteknikë”, “Hidroteknikë” dhe “Pyje”<sup>11</sup>. Gjithashtu, në platformë gjenden edhe 5 kurse udhëzuese për përdorimin e platformës dhe për zhvillimin profesional të mësuesve. Në secilën lëndë regjistrohen nxënës (të grupuar sipas klasave) dhe mësues, secili me të drejta e role të përcaktuara.

Ka disa kategori lëndësh në platformë:

- Lëndë të cilat kanë qenë më parë dhe tani po pasurohen me materiale të përshtatura;
- Lëndë të cilat hapen nga mësuesit në mbështetje të klasave virtuale. Mësuesit i hedhin paraprakisht materialet në mënyre të pavarur ose me ndihmën e stafit;
- Lëndë të klasës së 13-të që kanë materialet e temave të pazhvilluara nga programi orientues i maturës;
- Lëndë me materiale orientuese për lëndët e përgjithshme të maturës;
- Kurse formimi profesional (Guida dhe Kuzhina nga Qendra e Formimit Profesional Vlorë).

Materialet e klasave të 13-a që janë përgatitur nën koordinimin e S4J dhe kanë ndjekur një proces të sigurimit të cilësisë si në figurë. Përdorimi i platformës “MësoVet” ka disa avantazhe në raport me përdorimin e rrjeteve sociale për komunikim të shpejtë, si:


- ✓ Krijon mundësi organizimi të materialeve të ndryshme mësimore (tekst, format PDF, prezantime, *quiz*-e, video të lidhura me kanalin *Youtube*, linqe nga interneti etj.), në mënyrë tërheqëse dhe që nxisin ndërveprim;
- ✓ Materialet janë të redaktueshme dhe mund të pasurohen sipas nevojës me kalimin e kohës, madje vit pas viti;

---

<sup>10</sup> Learning management systems

<sup>11</sup> Sipas të dhënave me datë 29 mars 2020

- ✓ Testimet mund të vendosen bashkë me çelësin e zgjidhjeve në mënyrë që reagimi për rezultatet dhe dokumentimi i tyre të jetë më i shpejtë. Ky avantazh po përdoret për testet e tremujorit dhe tezat përgatitore për provimet të nivelit teorik;
- ✓ Çdo nxënës e mësues ka llogarinë e vet e mund të shohë progresin individual;
- ✓ Mësuesit mund të monitorojnë veprimtarinë e nxënësve në platformë dhe të nxjerrin raporte të ndryshme;
- ✓ Mund të krijohen grupe pune virtuale dhe të diskutohet në *chat/forum*;
- ✓ Përdoruesi ka qasje në çdo çast në aktivitetet e lartpërmendura.



Për të ndikuar në cilësinë e mësimit në distancë, po i kushtohet një vëmendje edhe mbështetjes së mësuesve, jo vetëm në aspektin teknik të përdorimit të platformës, por, më e rëndësishmja, në aspektin pedagogjik. Për këtë është hapur një kurs *online* për mësimdhënien efektive në distancë sipas eksperiencës botërore dhe shembujve të suksesit. Gjithashtu, çdo të shtunë po organizohen *webinar*-e për të ndarë eksperiencat.


Edhe këtu del qartë në pah se qasja në internet është problemi më i madh në mundësimin e mësimit në distancë. Nxënësit që s’përfitojnë nga ky shërbim janë të kufizuar në këtë proces. Fatkeqësisht nuk ka informacion si ata e mbajnë lidhjen me mësuesit apo nëse/si po vijnë procesin mësimor.

Nga të dhënat e vazhdueshme që projekti mbledh për anëtarësimin dhe frekuentimin e platformës “MësoVET” nga nxënësit e AFP rezulton se pjesa dërrmuese e nxënësve që frekuentojnë platformën janë nxënësit me mesatare më të lartë.


## 8.2. Rezultate nga përdoruesit e MësoVET

Rreth 20% (n=443) e nxënësve pjesëmarrës në studim deklaruan se përdornin platformën “MësoVET”, vetëm ose të kombinuar, për realizimin e mësimit në distancë *online*. Pjesa më e madhe janë nxënës në shkollën “Kolin Gjoka” në Lezhë (26.4%) dhe në shkollën “Salih Çeka” në Elbasan. Numri më i ulët i përdoruesve të kësaj platforme ishte në dy shkollat e Beratit.

### SHKOLLA




### DREJTIMI




Gati 1/3 e përdoruesve të MësoVet (31.4%) ishin të drejtimit “Agjenci turistike”, ndjekur nga nxënësit e drejtimit “Tekstil-Konfeksione” (24.4%), më pas ata të drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore” (23%) dhe në përqindje më të ulët drejtimit e tjera: “Mekanikë” (6.2%), “Instalues i sistemeve termohidraulike” (5.2%), “Sisteme mjeteve transporti” (3.4%), “Elektroteknikë” (3.2%) dhe “Ekonomi-Biznes” (2.1%).

Në aspektin gjinor, 62% e nxënësve përdorues të platformës digjitale “MësoVet” janë djem dhe 38% janë vajza. Pjesa më e madhe e tyre, 42.4%, janë të klasës së 13-të, nxënësit e klasës së 11-të dhe 12-të janë në përqindje të përafërt, respektivisht 23.3% dhe 22.3%, dhe numrin më të vogël e zinin nxënësit e klasës së 10-të, 12%.

GJINIA





KLASA



Pjesa dërrmuese e nxënësve përdorues të MësoVet e ndjekin mësimin nëpërmjet celularit (79.7%); 17.2% nëpërmjet *laptop*-it apo kompjuterit, dhe 2.3% nëpërmjet TV. 4 nxënës përdorues të MësoVet shprehen se nuk kanë pajisje me të cilat të mund të ndjekin mësimin në distancë *online*.

Unë mësimin online në distancë...






Një nga elementet më të rëndësishme për realizimin e mësimit në distancë *online* është pa dyshim akses në internet. Më shumë se gjysma e nxënësve përdorues të MësoVet, 55.8%, kishin akses në internet gjatë gjithë kohës, e ngjashme kjo me pjesën tjetër të nxënësve. 34% kishin akses me raste dhe 9.9% nuk kishin fare akses në internet.


Siç u theksua edhe më parë, nxënësve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë 0 = “Plotësisht jo dakord” deri në 4 = “Plotësisht dakord” disa aspekte kyçe të mësimit në distancë *online* që lidhen ngushtë me platformën digjitale që ata kishin në përdorim për mësimit. Të dhënat paraqiten fillimisht në përqindje për secilën pyetje sipas shkallës në dy grafikë të veçuar: një grafik për ata nxënës që e përdorin platformën dhe një tjetër për nxënësit që përdorin platforma të tjera.

## PËRDORUES TË MËSOVET



## PËRDORUES TË PLATFORMAVE TË TJERA

Plotësisht jo dakord 1 2 3 Plotësisht dakord




Siç vihet re në krahasimin mes dy grafikëve, nxënësit që janë përdorues të platformës “MësoVET” shprehin vazhdimisht e në përqindje më të lartë miratim maksimal në lidhje me secilën prej pyetjeve. Edhe pse ndryshimet janë të vogla në përqindje, ajo që bie në sy është ndryshimi i qëndrueshëm mes përdoruesve dhe jo përdoruesve të platformës digjitale “MësoVET”. Miratimin më të lartë nxënësit e shprehin lidhur me mundësinë për:

- pjesëmarrje në diskutime: MësoVet - 59.6%; Platforma të tjera - 54%;
- mënyrën e shpjegimit të mësuesve: MësoVet - 53.3%; Platforma të tjera - 48.7%;
- gjuhën e përdorur në platformë: MësoVet - 52.4%; Platforma të tjera - 48.4%.


Nxënësit që përdorin MësoVet kanë frekuentim më të lartë të orëve *online* (47.9%) krahasuar me 40% të përdoruesve të platformave të tjera. Këta nxënës kanë më pak vështirësi në kuptimin e mësimdhënies *online* (23%) kundrejt 27.1% të nxënësve përdorues të platformave të tjera. Gjithashtu, 32.1% prej tyre besojnë se MësoVet ndikon pozitivisht në formimin e tyre kundrejt 29% të përdoruesve të platformave të tjera. Ndryshime më të vogla u vunë re në mendimet e tyre për mësimin online në të ardhmen, llojin e detyrave, etj.

Diferencën e qëndrueshme në të gjitha pyetjet e nxjerr më qartë në pah krahasimi i vlerave mesatare mes përdoruesve të platformës “MësoVet” dhe nxënësve që përdorin platformat e tjera.





Në mënyrë grafike paraqiten rezultatet e 19 pyetjeve drejtuar përdoruesve dhe jo përdoruesve. Krahasimi i mesatareve tregon qartë ndryshimin e qëndrueshëm ndërmjet dy grupeve. Për të analizuar më tej nëse këto ndryshime të vogla por të qëndrueshme, për pjesën dërrmuese të çështjeve u realizua një test i pavarur “t”. Nga analiza rezulton se ndryshimet ishin statistikisht të rëndësishme për 5 prej pyetjeve të paraqitura në grafikun e mëposhtëm.



Të pesta dimensionet me ndryshime janë statistikisht të rëndësishme në ndikimin që mund të kenë në përdorimin e mëimit *online*. Nxënësit që përdorin MësoVET janë më të kënaqur me shpjegimin e mësuesve, mendojnë se gjuha e përdorur në platformë është e kuptueshme, janë frekuentues më të rregullt të mësimdhënies në distancë *online*, janë më të kënaqur me orientimet e mësuesve për të përdorur platformën dhe arrijnë të kuptojnë më mirë shpjegimin në distancë *online* (pyetja ka të njëjtën shkallë matëse por kahu është i kundërt).

### 8.3. Analizë e detajuar statistikore për realizimin e praktikës

Orët e praktikës profesionale sipas drejtimeve

A po realizohen orët e praktikës profesionale?	Po realizohen nëpërmjet projekteve të ndryshme		Po realizohen nëpërmjet praktikës në kushtet e shtëpisë		Nuk po realizohen		Pa përgjigje/ Përgjigje tjetër	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Ekonomi-Biznes	115	23.00%	293	58.50%	76	15.20%	17	3.40%
Elektrike					1	100.00%		
Elektronikë	16	33.30%	21	43.80%	10	20.80%	1	2.10%
Elektroteknikë	96	38.10%	85	33.70%	65	25.80%	6	2.40%
Elektroteknikë (integruar me Elektronikë)	15	40.50%	10	27.00%	11	29.70%	1	2.70%
Hoteleri-Turizëm	97	20.40%	298	62.60%	76	16.00%	5	1.10%
Instalues i sitemeve termohidraulike	30	33.30%	42	46.70%	13	14.40%	5	5.60%
Mekanikë	48	32.20%	72	48.30%	25	16.80%	4	2.70%
Ndërtim	11	47.80%	8	34.80%	1	4.30%	3	13.00%
Pa përgjigje			6	100.00%				
Shërbime sociale dhe shëndetësore	13	38.20%	9	26.50%	12	35.30%		
Shërbime mjtesh transporti	97	43.10%	98	43.60%	24	10.70%	6	2.70%
Teknologji informacioni dhe komunikimi	132	41.90%	126	40.00%	48	15.20%	9	2.90%
Teknologji ushqimore	1	12.50%	3	37.50%	4	50.00%	0	
Tekstil-konfeksione	4	11.40%	30	85.70%	1	2.90%	0	
	675	30.70%	1101	50.00%	367	16.70%	57	2.60%

34

### Orët e praktikës profesionale sipas shkollave



## 8.4. Teksti i pyetësorëve të përdorur gjatë sondazheve

### Pyetësi me nxënësit

#### Mendimet e nxënësve mbi mësimin në distancë *online* gjatë kohës kur shkollat janë të mbyllura

*Të dashur nxënës: Pyetësi i mëposhtëm është hartuar për një studim mbi nevojat dhe pritshmëritë e nxënësve tani që mësimi bëhet në distancë online. Lexo pyetjet me kujdes dhe zgjidh alternativën më të mirë për përgjigje.*

*Askush nuk i merr vesh të dhënat e tua personale. Kujdesu për veten e mos dil jashtë këto ditë.*

---

---

1. Unë ndjek shkollën \_\_\_\_\_ Zgjidhni shkollën që ndiqni

2. Drejtimi \_\_\_\_\_

3. Profili \_\_\_\_\_

4. Gjinia

- Vajzë
- Djalë

5. Klasa

- Klasa e 10
- Klasa e 11
- Klasa e 12
- Klasa e 13

6. Me çfarë platforme digjitale ose në distancë jeni duke mësuar aktualisht:

- Orët mësimore në RTSH
- WhatsApp
- MësoVet
- Google Classroom
- Platforma digjitale si NetAcad
- E kombinuar: WhatsApp dhe MësoVet
- Tjetër

7. Unë mësimin online në distancë e ndjek nëpërmjet:

- Kompjuterit
- TV
- Laptopit

- Celularit
- Nuk kam pajisje për të ndjekur mësimin online
- Tjetër

#### 8. Unë kam internet gjatë gjithë kohës

- Po
- Jo
- Me raste

#### Mendimet tuaja në lidhje me mësimin online në distancë

Më poshtë do të gjeni disa fjali në lidhje me mësimin në distancë që jeni duke kryer aktualisht. Për secilën fjali jep mendimin tënd se sa dakord je me secilën fjali duke zgjedhur vetëm njërën mundësi:

- 0 = plotësisht jo dakord  
 1 = jo dakord  
 2 = deri diku dakord  
 3 = shumë dakord  
 4 = plotësisht dakord.

Zgjidh me kujdes mundësinë që shpjegon më mirë mendimin tënd për secilën fjali!

1. Unë po e ndjek rregullisht mësimin në distancë.
2. Unë jam i/e kënaqur me sistemin që po përdoret nga shkolla jonë për mësimin online në distancë.
3. Mund të marr pjesë rregullisht në diskutime gjatë mësimit online në distancë.
4. Nuk arrij të kuptoj mësimin pasi kam vështirësi të ndjek shpjegimin online në distancë.
5. Unë jam i/e kënaqur me shpjegimet dhe këshillimin e mësuesve.
6. Unë jam i/e kënaqur me materialet mësimore vizuale që na dërgohen me WhatsApp ose email si video, foto, etj.
7. Unë jam i/e kënaqur me lehtësinë e përdorimit të platformës digjitale.
8. Jam i/e kënaqur me materialet e platformës digjitale (p.sh. libra, revista, etj.).
9. Jam i/e kënaqur me orientimet e mësuesve në përdorimin e platformës digjitale.
10. Jam i/e kënaqur me kohën e dhënë për të kryer detyrat e mia.
11. Unë jam i/e kënaqur me llojin e detyrave që na jepen.
12. Unë jam i/e kënaqur me mënyrën e vlerësimit që po përdorin mësuesit.
13. Dua që kjo formë e mësimit të vazhdojë edhe në të ardhmen.
14. Mësuesit na orientojnë të përdorim platformën për quiz-e (kuice) apo dërgim detyrash.
15. Gjuha e përdorur në platformën digjitale është e kuptueshme.
16. Platforma digjitale më lejon që të bëj teste vetë.
17. Përdorimi i platformës digjitale përmirëson aftësitë e mia.
18. Jam i/e kënaqur me grafikët, videot dhe skemat që janë vendosur nga mësuesit në platformën digjitale.
19. Unë di ta përdor shumë mirë platformën digjitale.

**20. Unë mendoj që në platformën digjitale që ne përdorim duhet të ketë:**

- më shumë materiale për të gjitha lëndët
- materiale të plota për lëndët
- më shumë video
- materiale më të shkurtra
- më shumë materiale interaktive
- më shumë testime
- më shumë mundësi për diskutime online në grup
- tjetër

**29. Orët e praktikës profesionale në kushtet e mësimit në distancë:**

- Po realizohen nëpërmjet projekteve të ndryshme
- Po realizohen nëpërmjet praktikës në kushtet e shtëpisë
- Nuk po realizohen
- Tjetër

**30. Sa dakord jeni me fjalinë: "Unë jam i/e kënaqur me mënyrën se si po realizohen orët e praktikës profesionale në kushtet e mësimit online në distancë"**

- 0 = plotësisht jo dakord
- 1 = jo dakord
- 2 = deri diku dakord
- 3 = shumë dakord
- 4 = plotësisht dakord.

37

---

**31. Në lëndët që unë ndjek mësuesit përdorin metoda të ndryshme vlerësimi si:**

- testime në formë quiz
- pyetje të hapura
- detyra në formë projekti
- punë me grupe
- Tjetër

**32. Mendimet e tua në lidhje me mësimin online në distancë mund t'i shkruani këtu më poshtë.**

Faleminderit për bashkëpunimin!

## Pyetësi me mësuesit

### Pyetësor i shkurtër mbi mësimin në distancë gjatë kohës kur shkollat janë të mbyllura

Mbyllja e shkollave në gjithë Shqipërinë për shkak të parandalimit të shpërndarjes së Covid-19, ka bërë që mësimi i drejtpërdrejtë të zëvendësohet me alternativa online. Projekti “Aftësi për Punë” nëpërmjet këtij pyetësi të shkurtër synon të evidentojë mënyrat se si po zhvillohet mësimi në distancë në shkollat e arsimit dhe formimit profesional, të kuptojë sfidat me të cilat përballen mësuesit dhe nxënësit si dhe të kontribuojë në përmirësimin e këtij procesi.

Plotësimi i pyetësit merr vetëm 5 minuta nga koha juaj. Të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe të pайдentifikueshme.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin dhe për kohën tuaj!

---

Ju lutem shkruani shkollën në të cilën ju jepni mësim

---

**1. Mendoni që mësimi në distancë bazuar në teknologjitë online është zgjidhja e duhur në situatat kur shkollat duhet të qëndrojnë fizikisht të mbyllura?**

- Po
- Jo

**2. Nëse “jo”, zgjidhja do të ishte:**

- Të pritet sa të hapet shkolla
- Të bëhen zëvendësime të shtunave dhe të dielave pasi të hapen shkollat
- Tjetër

**3. Zgjidhni mes alternativave në vijim për të vlerësuar si po shkon përdorimi i mësimin në distancë tani për tani:**

- Nxënësit nuk janë shumë aktivë
- Ndërveprimi (interaktiviteti) mësues-nxënës vështirë se arrihet
- Ka pengesa në proces pasi jo të gjithë nxënësit kanë internet dhe kompjuter/telefon
- Po jep rezultate, ka interaktivitet mes mësuesve dhe nxënësve
- Ka interes nga të gjithë aktorët, mësues, nxënës dhe prindër
- Po përdoret pasi është “urdhër nga lart”
- Jo të gjithë mësuesit kanë trajnimin e duhur për të kryer mësim online
- Jo të gjithë mësuesit kanë internet dhe kompjuter/telefon
- Tjetër

**4. Cilat nga metodat e aplikuara për të realizuar mësimin në distancë ju duket e duhura tani për tani?**

- Mësimi nëpërmjet grupeve Whatsapp
- Mësimi nëpërmjet TV
- Mësimi nëpërmjet platformave digjitale, si për shembull: MësoVet, NetAcad etj
- Tjetër

**5. Ju çfarë po përdorni aktualisht?**

- Grupe Whatsapp
- Orët mësimore në RTSH të rekomanduara nga Ministria
- Platforma digjitale si MësoVet, NetAcad
- Tjetër

**6. Përse po përdorni këtë mënyrë/metodë?**

- Më duket më rezultativja
- Është më e lehta për t'u përdorur nga nxënësit
- Këtë mënyrë ka vendosur të ndjekë shkolla/drejtoria
- Kjo është metoda që unë njoh më mirë
- Tjetër

**7. A po përdoret e njëjta mënyrë/metodë nga të gjithë mësuesit e shkollës?**

- Po
- Jo
- Nuk e di

**8. Cilat janë sfidat aktuale të mësimin online/në distancë**

- Mungesa e internetit
- Mungesa e monitorimit të pjesëmarrjes së nxënësve
- Vështirësi në vlerësimin e nxënësve
- Vështirësi në dokumentim e raportim
- Mungesa e aftësive digjitale
- Mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara
- Tjetër

**9. A do ta përdornit të mësuarin online edhe në të ardhmen, kur të hapen shkollat?**

- Po
- Jo

**10. Cfarë mund të përmirësohet për realizimin e mësimin në distancë?**

- Kapacitetet e nxënësve
- Kapacitetet e mësuesve
- Infrastruktura fizike
- Materialet digjitale
- Tjetër

**11. Cfarë ndihme mund të ofrojë projekti “Aftësi për Punë/ Skills for Jobs” në përmirësimin e cilësisë së mësimin në distancë?**

---

---

---

*Faleminderit për bashkëpunimin!*



## 8.5. Tabela me informacion më të hollësishëm statistikor




Figura 17: Mendimi i mësuesve për përzgjedhjen e mësimit në distancë




Figura 18: Metoda e duhur për mësimin online sipas mësuesve

## ÇFARË MUND TË PËRMIRËSOHET PËR REALIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË?




Figura 21: Mendimi i mësuesve për përmirësimet e mësimin në distancë

## PJESËMARRJA E NXËNËSVE NË SONDAZH SIPAS QYTETEVE




Figura 20: Pjesëmarrje e nxënësve në sondazh sipas qyteteve

## PJESËMARRJA NË SONDAZH SIPAS GJINISË



Figura 19: Pjesëmarrja e nxënësve në sondazh sipas gjinisë




Figura 22: Pjesëmarrja e nxënësve sipas vitit shkollor




Figura 23: Përzgjedhja e platformës nga nxënësit bazuar në kombinimin e fjalëve kyçe

Tabela 3: Vlerësimet që janë në përdorim nga mësuesit sipas nxënësve

LLOJET E VLERËSIMEVE TË PËRDORURA NGA MËSUESIT	%	Nr
Detyra në formë projekti	24.4%	535
Pyetje të hapura	23.7%	520
Testime në formë quiz	8.9%	196
Pyetje të hapura, detyra në formë projekti	8.3%	181
Punë me grupe	8.2%	179
Testime në formë quiz, detyra në formë projekti	4.6%	101
Testime në formë quiz, pyetje të hapura, detyra në formë projekti	4.2%	91
Testime në formë quiz, pyetje të hapura, detyra në formë projekti, me grupe	3.8%	83
Testime në formë quiz, pyetje të hapura	2.8%	61
Pyetje të hapura, detyra në formë projekti, punë me grupe	2.3%	50
Detyra në formë projekti, punë me grupe	1.7%	37
Pyetje të hapura, punë me grupe	1.7%	36
Testime në formë quiz, pyetje të hapura, punë me grupe	0.7%	14
Testime në formë quiz, punë me grupe	0.6%	12
Testime në formë quiz, detyra në formë projekti, punë me grupe	0.5%	11
Pa përgjigje, te kombinuara	3.7%	81

## 8.6. Instrumentet e monitorimit dhe raportimit në shkolla

Tabela e raportimit të mësuesit kujdestar

Klasa \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ 2020

Nxënës gjithsej \_\_\_\_\_

Mësuesi kujdestar \_\_\_\_\_

Nr	Lënda	Nxënës në mësim	% e Aktivizimit	Mësuesi i lëndës	Shënime të mësuesit
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Model Raportimi i Drejtorisë Arsimore

Mësoret.al	
Të tjera	
Messenger	
Facebook	
Google Forms	
WhatsApp	
Shënoni formën e vlerësimit (WhatsApp, Google Forms, Facebook, Messenger, SMS, Youtube, etj.)	
Numri i nxënësve që janë vlerësuar deri sot në datë 24 mars 2020	
Numri i nxënësve me të cilët nuk komunikohet	
Numri i nxënësve me të cilët jane krijuar grupet e WhatsApp, Facebook, Messenger, SMS, etj.	